



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

EU QENDRA E KUVENDIT

EU LAJME

dhjetor 2015

EUC-numër 17/2015



MIRATIMI I MARREVESHJES GLOBALE PËR KLIMËN



Përfaqësues nga 195 vende në Konferencën e KB për ndryshimet klimatike që u mbajt më 30 nëntor deri më 12 dhjetor në Paris, e miratuan Marrëveshjen e parë globale për luftë kundër ndryshimeve klimatike. Marrëveshja do të duhet të mundësojë zvogëlim të ngrohjes së planetit. Me marrëveshjen vendoset që rritja e temperaturave deri në fund të shekullit të mbahet më pak se 2 gradë celsius dhe nxehtësia të kufizohet në 1,5 gradë celsius lidhur me periudhën e para industrializimit.

Qëllimet e vendosura do të arrihen ashtu që vendet do të punojnë për zvogëlimin e emisioneve të gazrave serë qelqi.

Që të hyj në fuqi, marrëveshja duhet të ratifikohet nga 55 vende pjesa e të cilave në emisionin e kopshteve të gazrave serë qelqi është 55%.

Me qëllim që të ngadalësohet ngrohja globale në masën e dëshiruar vendet premtojnë se do të fillojnë sa më shpejt që është e mundur me zvogëlimin e emisioneve. Në afat të gjatë, marrëveshja parasheh që të bëhen përpjekje që emisionet e shkaktuara përmes aktiviteteve njerëzore të realizohen në atë nivel që drurët, toka dhe oqeani do të munden ti absorbojnë në mënyrë natyrore.

Vendet të cilat emetojnë gazra (187) i dorëzuan te KB-ja qëllimet e tyre të parashtruara për zvogëlimin e emisioneve deri më 2025 ose 2030, përpjekjet nuk do të jenë të volitshme për zvogëlimin e temperaturave në masën e dëshiruar. Prandaj vendet thirren që ti revidojnë qëllimet e veta në 4 vitet e radhës. Nga vendet nuk kërkohet të vendosin qëllime ambicioze por tu lihet hapësirë se shfrytëzimi i burimeve ripërtëritëse të energjisë do të jetë do të jetë më i qasshëm.

Me marrëveshjen është paraparë që vendet çdo pesë vite, nga viti 2025 ti revidojnë qëllimet dhe mundësitë e veta për zvogëlimin e emisioneve.

Edhe pse dokumenti nuk parasheh dënime për vendet të cilat nuk do të plotësojnë qëllimet e veta, prapëseprapë përmban rregulla për transparencë të cilat duhet ti nxisin vendet për realizimin e premtimit. Në pajtim me marrëveshjen, vendet do të parashtrorin raporte për emisionet dhe përpjekjet për zvogëlimin e tyre. Vendet e zhvilluara do të

vazhdojnë të sigurojnë përkrahje financiare të vendeve të varfra dhe vendeve të cilat tashmë janë ekspozuar në pasojat e ndryshimeve klimatike, ndërsa vendet tjera inkurajohen që të kyçen në përpjekjet e bazës vullnetare. Me këtë u hapet mundësi vendeve si Kinës, ekonomitë e të cilës zhvillohen me shpejtësi, të kyçen në këto përpjekje.

Në marrëveshje nuk theksohet shuma konkrete, por prapëseprapë vendet e pasura paraprakisht premtojnë se deri më vitin 2020 do të sigurojnë 100 miliard dollarë për ndihmë të vendeve të varfra.

Vendet e vogla mesdhetare janë më të ekspozuara në ndryshimet klimatike dhe në to deri në shkallë të caktuar u është dalë në ndihmë për shkak se marrëveshja sugjeron për humbjet dhe shpenzimet të cilat mund të priten nga katastrofat e shkaktuara nga ndryshimet klimatike, në të cilat matej nuk mund të përshtaten. Me fusnotë në tekstin e marrëveshjes, saktësohet se ajo nuk nënkupton e as jep bazë për çfarë do thirrje të përgjegjësisë dhe kompensim të dëmit, që ishte kërkesë kryesore e SHBA-ve.

Marrëveshja do të duhet të ndikojë në mënyrë pozitive në kalimin e ekonomisë botërore drejt burimeve tjera të energjisë në vend të shfrytëzimit të derivateve fosile.

Ekspertët sugjerojnë se zvogëlimi i emisioneve në nivel që mundet të absorbohet në mënyrë natyrore do të thotë se bota në gjysmën e shekullit tjetër do të pushojë me emetimin e gazrave të cilët rrjedhin nga djegia e naftës, qymyrit dhe gazit. Arritja e këtij qëllimi do të thotë ndryshim i plotë i sektorit energjetik. Shumë aktivitete janë të brengosur se vendet edhe krahas premtimeve nuk janë të gatshme për zbatimin e ndryshimeve të atilla radikale dhe të shtrenjta.

Marrëveshja e Parisit paraqet marrëveshjen e parë globale për luftë kundër ndryshimeve klimatike. Dokumenti paraprak i ngjashëm, Protokolli i Kjosës në vitin 1997 i obligoi vendet e zhvilluara që të zvogëlojnë emisionet.

<http://www.cop21.gouv.fr/en/>

Содржина на вестите:

Miratimi i marrëveshjes globale për klimën	1
Aktivitetet e Kuvendit	2-3
Në fokusin e Parlamentit Evropian	4
13 milion euro të reja nga BE-ja nga BE-ja për Ballkanin Perëndimorë	5
Një miliard euro për Ballkanin	5
Reforma e Gjykatës Evropiane të	6
Zgjedhjet Parlamentare në Spanjë	7
Direktiva për qasje më të mirë re prodhimet dhe shërbimet e personave me	8
Strategji e re BE për aviacion	9
Mediat sociale si burim për informata shëndetësore	10
Rregulla të reja për përmirësimin e sigurisë sajber	10
Gjuha e Irlandës me status si gjuhë zyrtare e BE-së	11
Kryesia e Holandës me Këshillin e BE-së	11
Kalendari BE janar 2016	11

AKTIVITETET E KUVENDIT

U mbajt takimi i 13-të i Komitetit të Përzier Parlamentar Republika e Maqedonisë dhe Bashkimi Evropian



Më 3 dhe 4 dhjetor 2015 në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë u mbajt mbledhja e 13-të i KPP-RM dhe BE, me të cilin kryesuan Kenan Hasipi dhe Alojz Peterle. Në mbledhje krahas anëtarëve të Komitetit të Përzier Parlamentar ishin prezent edhe Fatmir Besimi, nënkryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i obliguar për eurointegritime, si dhe Aivo Orav ambasador dhe shef i Delegacionit të BE-së në Republikën e Maqedonisë.

Në mbledhje u shqyrtuan më shumë çështje lidhur me marrëdhëniet e Republikës së Maqedonisë me BE-në, implementimi i marrëveshjeve nga 2 qershori dhe 15 korriku dhe qëllimet e parapara nga dialogu aderues në nivel të lartë, me përqendrim të veçantë për: Sundimin e të drejtës, reformat në gjyqësi dhe luftën kundër korrupsionit; reformën zgjedhore dhe zgjedhjet e ardhshme parlamentare; lirinë e medieve dhe dialogun ndërmjet bashkësive. Në kontest të raporteve të Komisionit Evropian

për Republikën e Maqedonisë në vitin 2015, si dhe Strategjinë për zgjerimin e BE-së dhe Dialogun aderues në nivel të lartë, u këmbyen mendime nga ana e z. Besimi, nënkryetar i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i obliguar për eurointegritime Fatmir Besimi, Aivo Orav shef i Delegacionit të BE-së dhe këmbim të mendimeve me Nikolla Poposkin, ministër i Punëve të Jashtme. Në mbledhje u bë fjalë për rrugën euro integruese të vendit tonë; vërejtjet në Raportin për progresin, reformat të cilat kryhen në vazhdimësi; zgjidhja e kontestit me emrin me Republikën e Greqisë, si pengesë kryesore për anëtarësim në BE dhe NATO; marrëdhëniet e mira fqinjësore; si dhe ballafaqimi i Republikës së Maqedonisë me krizën e migrimit. Pas diskutimit, vijuan prononcime edhe për lirinë e fjalës në media dhe për reformat në kodin zgjedhorë.

Në fund të mbledhjes, Komiteti i Përzier Parlamentar, dha [rekomandime](#) te institucionet e Republikës së Maqedonisë dhe të Bashkimit Evropian.

Mbledhja e Asamblesë Parlamentare të Dimensionit Parlamentar të iniciativës Evropiane Qendrore



Në suaza të Kryesisë së Maqedonisë me Iniciativën Qendrore Evropiane (IQE), më 10 dhjetor të viti 2015 në Kuvend u mbajt mbledhje e Asamblesë Parlamentare të Dimensionit Parlamentar të Iniciativës Qendrore Evropiane (DP IQE), me temë: "Krizë e migrimit si problem dhe sfidë globale: Sa është reale veç zgjidhja rajonale? (Evropa, IQE dhe Ballkani Perëndimorë)" dhe "Lidhja e ndërsjellë në BE, me kontest të veçantë në rajonin e IQE-së". Para mbledhjes pati takime të Komiteteve të Përgjithshme për çështje politike, ekonomike dhe kulturore në fokus të të cilit ishin migrimet, zgjerimi i BE-së dhe bashkëpunimi në strategjinë makroekonomike, secili në aspektin e vet. Mbledhjen, si dimension e hapi shefi i Delegacionit të Maqedonisë në DP IQE, Julijana Siljanovska, me çka shprehu kënaqësi që pas kryesimit të suksesshëm të para trembëdhjetë vitesh, këtë vit sërish pati nderin Maqedonia të kryesojë me inicialin më të vjetër rajonale, ndërsa prezenca e delegacionit është indikator për interesin e vendeve anëtare që të diskutojnë për tema të përbashkëta.



Hyrje dhe diskutime të veta patën edhe z. Trajko Veljanoski, kryetar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë; z. Erik Cernovic, zëvendëssekretar gjeneral i IQE-së; Marko Klestil Lofter, ndihmë i sekretarit gjeneral të

IQE-së dhe Draganço Apostolloski, zëvendës koordinator i CEI-së.

Lidhur me sesionin e parë prononcime të veta patën Oliver Spasovski, Ministër i Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë dhe Ermira Mehmeti, kryetare e Komisionit për Çështje Evropiane. U theksua se kriza e migrimit u tregua deri tani si sfidë e paparë në Evropë, asnjë vend nuk mundet të ballafaqohet vetë, por duhet të gjendet zgjidhje në nivel panevropian, ndërsa sulmet e mëparshme terroriste dëshmuar se jemi ballafaquar me kërcënim trans nacional dhe bashkërisht duhet të ndalemi kundër terrorizmit. Në sesionin e dytë si prioritet u nda zhvillimi i vazhdueshëm në infrastrukturën e transportit. U theksua rëndësia e investimeve në komunikacionin rrugorë, hekurudhorë dhe komunikacionin ajrorë dhe nevojën për reformë të shpejtuar dhe ndërtim të korridoreve kryesore. Funkcioni i plotë i korridoreve do të mundësojë lidhje më të mirë të vendeve dhe zhvillim të përforcuar ekonomik. Të pranishmit shprehën kënaqësinë nga temat e zgjedhura për mbledhjen, të cilat janë me rëndësi të veçantë për sigurinë dhe integritimin e rajonit dhe Evropës në përgjithësi. Në fund u miratua [deklaracioni përfundimtar](#).

AKTIVITETET E KUVENDIT

Dy debate publike në organizim të Këshillit Nacional për eurointegritime

Këshilli Nacional për Eurointegritime më 24 dhjetor të vitit të kaluar organizoi debat publik për **"Prioritetet urgjente të reformave për Republikën e Maqedonisë"**, dokument i Komisionit Evropian nga qershori i vitit 2015. Prioritetet urgjente të reformave të cilat duhet ti plotësojnë nga ana e Republikës së Maqedonisë kane të bëjnë me sferat në vijim: sundimi i të drejtës dhe të drejtat fundamentale, depolitizimi i administratës publike, liria e shprehjes dhe reforma zgjedhore. Në debatin publik u drejtua z. Fatmir Besimi, zëvendëskryeministër i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i obliguar për integritime evropiane, me çka theksoi se prioritetet urgjente të reformave lidhen ngushtë me të dy dokumentet të cilat Komisioni Evropian i miratoi së fundmi - Strategjia për Zgjerimin e BE-së dhe Raporti për Republikën e Maqedonisë për vitin 2015. Në debatin publik u theksuan mendimet dhe qëndrimet në lidhje me sundimin e të drejtës dhe gjyqësisë, mbikëqyrjes parlamentare mbi përcjelljen e komunikimeve, për trupat rregullatorë, kontrollues dhe mbikëqyrës, depolitizimin e administratës publike, reformës zgjedhore, lirinë e shprehjes, si dhe për rekomandimet e Komisionit për të hetuar ngjarjet në Kuvend nga 24.12.2012.

Me mendime, propozime dhe komente te veta morën pjesë: Lidhja Dimova kryetare e KNEI-së, Ermira Mehmeti kryetare e Komisionit për Çështje Evropiane, Dimitar Srevananxhija anëtar i KNEI-së, Goran Misovski kryetar e Komisionit për mbikëqyrje mbi punën mbi zbatimin e masës së veçantë hulumtuese përcjellje të komunikimeve, Suad Misini nga Qendra Hulumtuese për Shoqëri Civile, Bojan Mariçiq nga QEEM, Fani Karanfilovska Panevska nga FSHHM, Biljana bekova nga OJQ Infoqendra, Samka Ibrahimovski nga PEPR dhe Misha Nga Instituti për Demokraci "Societas Civilis".

Këshilli Nacional për Eurointegritime me 22 dhjetor të vitit 2015 organizoi debat publik me temë **"Republika e Maqedonisë në Kornizën Energjetike Evropiane"**. Në debatin publik fjalime patën: Kryetarja e KNEI znj. Lidija Dimova, përfaqësuesit e Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe Arteve akademiku Grigor Konevce dhe prof. Natasha Markovska, përfaqësuesja e Ministrisë së Ekonomisë dhe Këshilltarja Shtetërore për Energjetikë dhe lëndë të para minerale znj. Violeta Keckarovska dhe përfaqësuesja e Qendrës për hulumtim dhe informim për mjedis jetësorë "Eko-vest". Ana Çoloviq Leshovska. Në debatin publik lëndë debati ishte Strategjia ekzistuese për zhvillimin e energjetikës në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2008-2010 me vizion deri më 2030 dhe në veçanti Draft-strategjia për zhvillimin e energjetikës në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2035 e cila është përgatitur nga Akademia Maqedonase për Shkencë dhe Arte. Nga ana e përfaqësuesit të "Eko-vest" u prezantua dokumenti - Analiza e skenarëve për aderim në BE përmes programit të implementimit të Strategjisë për energjetikë, emisionet dhe qëllimet e përcaktuara nga ana e BE-së dhe në marrëveshjet tjera ndërkombëtare. Në debatin publik me mendimet e veta, propozimet dhe komentet morën pjesë: Solla Gërçeva deputete dhe anëtare e KNEI-së, Liljana Popovska deputete dhe anëtare e Komisionit për Politikë të Jashtme, prof. Konstantin Dimitrov nga Qendra për efikasitet energjetik të Maqedonisë, Alenksandra Bujaroska nga Fronti 21/42, Nevena Smileska nga "Eko Svest", Sonja Risteska nga Analitika, Andreja Stojkovski nga QEEM, Aleksandra Dukovski drejtor i Agjencisë për Energjetikë në Republikën e Maqedonisë, Aleksandar Goçev nga Plan 4D dhe Xhelal Xhokiq nga iniciativa civile "AMAN".



Komisioni për Çështje Evropiane më 23 dhjetor të vitit 2015 mbajti debat publik me temë: Si të kemi gjyqësi evropiane?

Fjalime hyrëse patën: Nënkryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i obliguar për Çështje Evropiane Fatmir Besimi, ministri i drejtësisë Adnan Jashari dhe drejtorja e Akademisë për gjykatës dhe prokurorë publik Aneta Arnaudovska. Të pranishmit u informuan se është përgatitur Strategjia 2016-2020 dhe Plani Aksionar për reformat në gjyqësi, në pajtim me kërkesat e legjislativës evropiane, praktikat më të mira evropiane dhe përvojat rajonale. Në debat morën pjesë deputetët Lidija Dimova, Orhan Ibrahim, Daniella

Rangellova, Liljana Popovska, Kenan Hasipi, kryetari i Këshillit për prokurorë publik Peta Anevski dhe drejtorja e EPI-së Malinka Ristevska-Jordanova. Gjatë diskutimeve u theksua se gjyqësia e pavarur dhe e pa anshme paraqet një nga shtyllat fundamentale të sundimit të të drejtës, dhe me atë edhe të demokracisë fundamentale, që është një parakusht për aderim në vendet e BE-së.

Komisioni për Çështje Evropiane në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2015 e shqyrtoi pasqyrën Narrative të shkallës së realizimit të revizionit të NPAA-së për tremujorin e III-të nga viti 2015.

NË FOKUSIN E PARLAMENTIT EVROPIAN

Sesioni plenar 2 dhjetor 2015 Bruksel

Më 2 dhjetor të këtij viti euro-deputetët debatuan për propozimin e Komisionit Evropian për krijimin e ekonomisë qarkulluese. Para euro-deputetëve u prezantuan propozimet e reja ligjore, së bashku me planin aksionar.

Në drejtim të samitit BE-Turqi më 29 nëntor të vitit 2015, shumica e euro-deputetëve theksuan se financimi i Turqisë duhet të kontrollohet tërësisht për shkak se dyshojnë në vendimin e ristartimit të bisedimeve për aderimin e Turqisë në BE.

Puna e Komisionit Special Parlamentar për vendime tatimore do të vazhdojë me mandat të ri për gjashtë muaj, me fillim më 2 dhjetor të këtij viti. Kjo është vendosur në Konferencën e kryetarëve dhe është miratuar nga ana e Parlamentit me 561 vota kundër 69 dhe 5 të përmbajtur. Puna e Komisionit do të fokusohet në regjimet dhe praktikatat e dëmshme të tatimit korporativ në nivel evropian dhe ndërkombëtar.

Parlamenti e miratoi Marrëveshjen e BE-së dhe Lihteshtajnit për këmbim automatik të informatave për llogaritë bankare të rezidentëve. Me marrëveshjen pamundësohet që qytetarët të fshehin mjete në para nga tatimimi i llogarive të veta bankare. Marrëveshja do të zbatohet më vitin 2018.

Agjencia kufitare e BE-fronteks duhet të vendosë një sistem për ballafaqim me ankesat për shkelje të të drejtave themelore të migrantëve dhe të kërkuesve për azil. Kjo u theksua në rezolutën e miratuar nga euro-deputetët me 488 vota, kundër 114 dhe 33 të përmbajtur.

Lidhur me takimin e Këshillit të mbajtur më 7 dhjetor eurodeputetët e miratuan propozim-direktivën e BE-së me të cilën deri më vitin 2020 parashihet të paktën 40% të drejtorëve jo ekzekutiv të kompanive të jetë femra. Tani Këshilli i ministrave duhet ta merr qëndrimin e vet për propozimin dhe të fillojë bisedimet me Parlamentin.

Sesioni plenar 14-17 dhjetor 2015 Strasburg

Delegacioni prej 15 deputetësh nga Parlamenti Evropian morën pjesë në Samitin për klimën në Paris. Parlamenti Evropian duhet ta Ratifikojë marrëveshjen e arritur për klimën që paraqet një drejtim të qartë për klimën politike për kohën në vijim.

Parlamenti miratoi rezolutë për integrim të plotë të tregut të energjisë elektrike në BE me çka faturat për rrymën mund të zvogëlohen për 2 euro në MWh, me çka shfrytëzuesit do të kursejnë 40 miliardë euro deri në vitin 2030. Që të arrihet qëllimi, vendet e BR-së duhet të investojnë 150 miliardë euro për interkonektim të rrjeteve nacionale. Në rezolutë të veçantë e cila u miratua ekspozohet Bashkimi Energjetik që tu sigurojë qytetarëve evropian energji të sigurt, të qëndrueshme dhe konsiderueshme. Eurodeputetët e theksuan nevojën për shfrytëzim më të mirë të infrastrukturës energjetike ekzistuese nacionale dhe tej kufitare, me qëllim që energjia të shfrytëzohet në mënyrë efikase dhe të përforcohet siguria në furnizim.

Në debat me kryetarin e Komisionit, Zhan-Klodd Jumker, eurodeputetët deklaruan se liderët e BE-së duhet ta vazhdojnë krijimin e kufirit Evropian dhe rojet bregdetare dhe nga afër të bashkëpunojnë në luftë kundër terrorizmit.

Parlamenti Evropian miratoi ndihmë nga Irlanda prej 400 mijë eurosh dhe për 108 falimentues servises të avionëve, që do të ndihmojë në gjetjen e vendeve të reja të punës. Parlamenti u pajtua të sigurojë ndihmë të ngjashme nga BE -ja në vlerë prej 2,6 milion euro për 1.200 falimentues IT punëtorë në Finlandë. Të dy rastet për ndihmë nga Fondi Evropian për përshtatje drejt globalizimit (EGF) u miratuan nga Këshilli i ministrave në BE më 14 dhjetor.

Shpërblimi "Saharov 2015 për lirinë mendimit" iu nda Raif Badavi, aktivist saudit për të drejtat e njerëzve.

Parlamenti Evropian e miratoi marrëveshjen e re për vendosjen e bashkëpunimit policorë ndërmjet Evropolit dhe Bosnjës dhe Hercegovinës për intensifikimin e luftës së përbashkët kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe formave tjera të krimit serioz ndërkombëtar.

Parlamenti e përshëndeti 40-vjetorin e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet BE-së dhe Kinës.

Eurodeputetët votuan rezolutë në të cilën theksohet se BE-ja dhe Kina duhet të punojnë së bashku për ballafaqim me sfidat dhe kërcënimet globale, si terrorizmi, migrimi i pa ligjshëm, siguria, ndryshimet klimatike dhe financimin global dhe sundimin e tregut. Eurodeputetët thirrën në bisedime për përshpejtimin e hapit drejt arritjes së marrëveshjes së re për partneritet dhe bashkëpunim në bazë të besimit, transparencës dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Me rezolutë Parlamenti Evropian thirri menjëherë BE-në që të fillojë të përcjellë kërcënimet për demokracinë, sundimin e të drejtës dhe të drejtat themelore në Hungari. Komisioni duhet të vlerësojë nëse efekti i kombinuar i masave qeveritare ka shpër deri në "keqësim sistemorë" i cili mund të shkaktojë ngjarje të ngjashme edhe në vende tjera anëtare të BE-së.

Parlamenti Evropian miratoi vendim për formimin e komisionit anketues prej 45 anëtarësh, i cili do ta hulumtojë shkeljen e rregullave të BE-së për testet e emisioneve të gazrave të automobilave dhe gabimet eventuale nga ana e vendeve anëtare të BE-së dhe Komisionit Evropian në zbatimin e standardeve të BE-së. Komisioni do të prezantojë raport të përkohshëm në afat prej 6 muajsh, ndërsa raportin përfundimtar në afat prej 12 muajsh nga fillimi i punës së tij.

Propozimet e kaluara të Komisionit Evropian për financimin e Bashkimit Monetar Evropian (BME) janë të mjaftueshme që të ballafaqohet me mangësitë e tanishme në kornizat institucionale të euro-zonës.

Vendet anëtare duhet rreptësisht ta zbatojnë kodin prej tetë pikave të BE-së për eksportin e armëve, në veçanti me ndryshimin e sigurisë në na rrethon me shtetet fqinje të BE-së, u theksua në debat në Parlamentin Evropian.

<http://www.europarl.europa.eu/news/en>

KRIZA ME REFUGJATËT: 13 MILION EURO TE REJA NGA BE-JA PËR BALLKANIN PERËNDIMORË

Bashkimi Evropian më 10 dhjetor të vitit 2015 miratoi ndihmë të re humanitare urgjente prej 13 milion eurosh për Republikën e Maqedonisë dhe Serbinë, si dhe përkrahje për ballafaqim me krizën e refugjatëve që e kaploi Ballkanin Perëndimorë.

Duke pasur parasysh kushtet me të cilat ballafaqohen refugjatët në drejtim të Ballkanit Perëndimorë, me këtë ndihmë plotësuese humanitare do tu mundësojë strehim të përkohshëm, ushqim, ndihmë shëndetësore, ujë, dhe kushte sanitare.

Mjetet plotësuese prej 13 milion eurosh për Maqedoninë dhe Serbinë janë në shtojcë të shtatë milion eurove ndihmë humanitare nga buxheti humanitar i BE-së të këtij viti prej 200

milion euro për krizën në Siri dhe Irak. Shuma fillestare prej 1,74 milion euro është paraparë paraprakisht në vitin 2015 me qëllim që të tejkalohet përshtatja, pastaj Komisioni Evropian me kujdes e koordinoi ndihmën humanitare me financim në suaza të programeve para aderuese të BE-së.

Sipas Komisionit Evropian nga fillimi i vitit më shumë se 900.000 njerëz kanë arritur më Evropë përmes detit, ndërsa në nëntor sipas UNHCR-së ka pasur thujse 140.000 regjistrime në Evropë, që është 10 herë më shumë krahasuar me nëntorin e viti 2014. Në vitin 2015 më shumë se 83% të refugjatëve dhe migrantëve kanë arritur në Greqi, ndërsa shumica prej tyre më vonë kanë shkuar nëpërmjet Ballkanit perëndimorë drejt Evropës



NJË MILIARD EURO PËR BALLKANIN PERËNDIMORË DHE PËR TURQINË NGA IPA II

Komisioni Evropian më 11 dhjetor të këtij viti miratoi pako të programeve për ndihmën para aderuese për vitin 2015 për përkrahjen e reformave dhe bashkëpunim rajonal të Ballkanit Perëndimorë dhe Turqisë në shumë prej rreth një miliard euro. Mjetet nga 196,6 milion euro për Serbinë janë dedikuar për avancimin e demokracisë dhe të menaxhimit, sundimit të të drejtës dhe të drejtat themelore në sektorin transportues.

Për lidhjen e Ballkanit Perëndimorë janë paraparë 155 milion euro për 4 projekte energjetike dhe po aq projekte transportuese.

Për shkak të procedurave të ndërlikuara për planifikimit dhe përcaktimit zakonisht mjetet për vitin e caktuar të shpenzohen në vitin e radhës. Bëhet fjalë për mjetet nga Instrumenti për ndihmë para aderuese (IPA II) me të cilin në vendet e Ballkanit Perëndimorë dhe Turqisë inkurajohen reformat e mëtejme demokratike dhe ekonomike, modernizimi i gjyqësisë dhe administratës publike, si dhe bashkëpunimi rajonal.

Shumë më e madhe prej 155,1 milion euro është dedikuar për Turqinë, për Shqipërinë janë paraparë 89,9 milion, për B dhe H 37,2 milion, për Maqedoninë 24,1 milion, për Kosovën 78 milion, për Malin e Zi 25,1 milion dhe 15,23 milion euro nga programi aksionar shumë vjeçar 2015-17.

"Ky paket e tregon përkushtimin tonë të fuqishëm të perspektivës evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimorë dhe Turqisë. Ai është investim afatgjatë për stabilizimin e BE-së, sigurisë dhe prosperitetit dhe i përkrah reformat politike dhe ekonomike të vendeve në rrugën e vet drejt BE-së", theksoi komisar për politikë evropiane fqinjësore dhe negociata për zgjerim z. Johannes Han.

Për programet në të cilat marrin pjesë më shumë

vende nga rajoni, për vitin 2015 janë miratuar 122,55 milion euro. Paketa përfshin edhe 155,25 milion euro për programet për lidhje për vitin 2015-2016. Me këto mjete do të vazhdohet financimi i projekteve të mëdha infrastrukturore rajonale në energjetikë dhe transport të Ballkanit Perëndimorë - 4 inspektorate, 2 projekte rrugore dhe 2 hekurudhore.

Janë paraparë interkonektorë për lidhjen e elektro-rrjetit të Shqipërisë dhe Maqedonisë I dhe II dhe për vendosjen e korridorit trans-ballkanin I dhe II, seksione në Mal të Zi dhe Serbi.

Janë paraparë 2 projekte për lidhje rrugore të B dhe H dhe Kroacisë në suaza të korridorit Mediteran dhe 2 projekte hekurudhore - lidhja e Maqedonisë, Kosovës dhe Serbisë, si dhe Malit të Zi dhe Serbisë.

Realizimi i këtyre projekteve do ti afrojë ekonomitë dhe shoqëritë në rajon, dhe pritet edhe kontribut nga BE-ja në tërheqjen e huave nga institucionet financiare partnere në vlerë prej 540 milion euro.

Komisioni Evropian vlerëson se përmirësimi i lidhjes në vendet e Ballkanit Perëndimorë, si dhe ndërmjet atij rajoni dhe BE-së është kryesor për zhvillimin ekonomik të rajonit.

Komisioni thekson se lidhja është vendosur lart në listën e prioriteteve të BE-së me përkrahje të plotë të qeverive nga Ballkani Perëndimorë.

Kujdes të veçantë u përkushtua në përgatitjen dhe financimin e projekteve infrastrukturore investuese konkrete rajonale, si dhe zbatimin e standardeve teknike dhe kështu me radhë. "masa të dobëta", siç është thjeshtësimi i procedurave tej kufitare.

http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15



REFORMA E GJYKATËS EVROPIANE TË DREJTËSISË



«Gjykata Evropiane e Drejtësisë përbëhet prej tre pjesësh - Gjykata e Drejtësisë si instanca më e lartë gjyqësore e BE-së, Gjykata e Përgjithshme nën kompetencën e të cilës është e drejta e përbashkët e Bashkimit dhe Gjykata Administrative për konteste të nëpunësve dhe institucioneve»

Më 3 dhjetor të vitit 2015 Këshilli i BE-së e miratoi Rregullativën për reforma në Gjykatën e Përgjithshme të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Qëllimi i reformës është që mundësojë që Gjykata e Përgjithshme të ballafaqohet me vëllimin e rritur të punës dhe të sigurohet se mjeti juridik në BE kryhet në afat të matur.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë përbëhet prej tre pjesësh - Gjykata e Drejtësisë si instanca më e lartë gjyqësore e BE-së, Gjykata e Përgjithshme nën kompetencën e të cilës është e drejta e përbashkët e Bashkimit dhe Gjykata Administrative për konteste të nëpunësve dhe institucioneve.

Me reformën e propozuar, numri i gjykatësve në Gjykatën e Përgjithshme gradualisht do të rritet dhe Gjykata Administrative për konteste të nëpunësve dhe institucioneve do ti bashkëngjitet Gjykatës së Përgjithshme. Numri i gjykatësve në vitin 2015 rritet për 12, ndërsa 7 gjykatës nga Gjykata Administrative për konteste të nëpunësve dhe institucioneve në vitin 2016 do të barten në Gjykatën e Përgjithshme, të cilës në vitin 2019 do ti ndahen edhe 21 gjykatës plotësues.

Sipas të dhënave më të reja numri i lëndëve të cilat në vit parashtrihen te Gjykata e Përgjithshme është rritur në 912 lëndë në vitin 2014, në krahasim me 600 lëndë më pak para vitit 2010.

Në fund të marsit të vitit 2015, Gjykata u ballafaqua me 1270 lëndë të pa zgjidhura, ndërsa vlerësimet janë se numri i lëndëve të vlerësuara do të rritet.

Miratimi i aktgjykimeve për lëndët më të ndjeshme mesatarisht zgjat prej 4 deri 5 vjet, ndërsa te lëndët tjera në përgjithësi

llogaritet se zgjat një vit.

Neni 47 nga Karta për të drejtat themelore, e parasheh të drejtën e marrjes së aktgjykimit në afat kohor të matur.

Shpenzimet për rritjen e numrit të gjykatësve për 21 dhe bashkimi i dy gjykatave do të arrijnë 13,5 milion euro në vit. Kjo shumë është më e vogël krahasuar me 26,8 milion euro të cilat kërkohej në disa procedura të ngritura si kompensim i dëmit për shkak të vonimit në miratimin e aktgjykimeve.

Rregullativa do të publikohet në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe do të hyj në fuqi ditën e radhës pas publikimit.

Procesi për huazimin e 12 gjykatësve të parë plotësues është në rrjedhë. Kandidatët e propozuar nga ana e vendeve anëtare (Çeki, Suedi, Spanjë, Zvicër, Hungari, Poloni, Qipro, Lituani, Greqi, Letoni, Luksemburg, Sllovaki dhe Maltë) do të kalojnë në konsultime dhe intervista nga ana e komisionit të formuar në pajtim me nenin 255 nga Marrëveshja për funksionimin e BE-së.

Detyra e komisionit është që të japë mendim për përsosjen e kandidatëve për kryerjen e funksionit gjykatës të Gjykatës së Përgjithshme, para vendimit për emërimin e tyre nga ana e përfaqësuesve të qeverisë së vendeve -anëtare.

<http://www.consilium.europa.eu/en/press/>

Zgjedhjet Parlamentare në Spanjë

Partitë e reja politike në Spanjë- Podemos dhe Ciudadanos, do të mbajnë baraspeshë të fuqisë së negociatave paraprirës koalicionuese. Me zgjedhjet që u mbajtën më 20.12.2015 u shënuar fundi i sistemit politik dypartiak shumë dekadash në Spanjë, pasi që Partia Popullore nuk arriti të fitojë shumicë absolute.

Partia Popullore konservative në pushtet e kryeministrit Mariano Rajoh, fitoi më shumë vota dhe siguroi 123 vende deputetësh, fitoi 29% nga votat e Spanjollëve, por e humbi shumicën në Parlament i cili numëron 350 deputet. Për shumicë absolute janë të nevojshme 176 vende deputetësh.

Për Partinë socialiste votuan 22% nga votuesit në përbërjen e re të Kuvendit, do të kenë 90 vende deputetësh. Pablo Iglesias, lideri i partisë së re të majtë PODEMOS, e cila tani është fuqia e tretë politike në Spanjë me 69 vende të fituara dhe 21% nga votat, është kundër masave të ashpra të kursimit dhe shprehu se nuk do të lejojë që partisë në pushtet të formojë qeveri të re. Partia e Qendrës së djathtë- Ciudadanos fitoi 40 vende deputetësh dhe 14 nga votat.

Partia Podemos arriti rezultate të mira në tërë vendin, duke e fituar vendin e parë në Katalonia dhe Baskija, rezultat që sugjeron përkrahje të gjerë për premtim parazgjedhor që të mbahet referendum parazgjedhor në Katalonia.

Partia Ciudadanos është formuar në vitin 2006 si parti rajonale që të kundërvihet separatizmit katalonas i cili vitin e kaluar zgjerohet niveli nacional. Kjo parti gjithashtu e festonte rezultatin e tyre më 20.12.2015. Lideri i kësaj partie Albert Rivera porositi " Sot fillon fazë e re e shpresës, milion njerëzve në Spanjë vendosën se gjërat do të ndryshohet".

Rezultatet nga zgjedhjet lanë mundësi që lideri i Partisë Popullore konservative në pushtet Mariano Rajoh të bëhet lider i parë në Evropë i cili do të rizgjidhet pas imponimit të masave të rrepta për kursim. Gjithsesi, Rajoh ballafaqohet me betejë të rëndë për formimin e qeverisë. Partia popullore konservative, që të jetë në mundësi edhe katër vitet e ardhshme të jetë në Qeverisë, do të duhet të shpresojë në partitë tjera, që sugjerojnë se i paraprin proces i gjatë i negociatave mes liderëve partiak në Spanjë.

Sipas Guardian "Për herë të parë në histori të demokracisë në Spanjë, nuk është e qartë se për cilën parti u votua më së shumti, në mënyrë të secilës do të jenë në mundësi që të qeverisin vendin".

Mbreti Spanjoll Filip VI, deri në mesin e janarit 2016 do të duhet të emërojë parti e cila do të jetë në mundësi të formojë qeveri. Kandidati më pas do duhet të marrë shumicën e votave në votimin e besimit, kurse nëse nuk arrihet ajo, në afat prej 48 orësh do të mbahet votim me shumicë të thjeshtë. Nëse kandidati sërish nuk e fiton e nevojshëm të votave, mbreti duhet të propozojë kandidat të ri.

Nëse në afat prej dy muajve nuk formohet qeveri, Spanja do të duhet të mbajë zgjedhje të reja.



<http://www.theguardian.com/world/2015/dec/20/peoples-party-wins-spanish-election-absolute-majority>

Direktiva për qasje më të mirë re prodhimet dhe shërbimet e personave me nevoja të posaçme



Komisioni Evropian më 2 dhjetor 2015 propozoi Direktiva me të cilat vendosen kërkesat e përgjithshme për qasje deri tek prodhimet e caktuara dhe shërbime të cilat do t'i ndihmojë njerëzve me nevoja të veçanta për përfshirje të tërësishme në shoqëri.

Prodhimet dhe shërbimet me vëmendje janë zgjedhur në konsultim me qytetarët dhe organizatat të shoqërisë civile dhe biznes sektorit. Në ato bien bankomat dhe shërbime bankare, kompjuter, telefon dhe TV pajisje, telefoni dhe shërbime audivizuele, transport, e-libra dhe e-tregti.

Propozim direktiva ka për qëllim që të përmirësojë funksionimin e tregut të brendshëm, me atë që do të lehtësohet shitja tejkuftare e prodhimeve qasës dhe shërbime. Kërkesat e përgjithshme për qasje do të zbatohen edhe në suaza të rregullave për furnizime publike të BE dhe shfrytëzimin e BE fondeve.

Me këtë iniciative do të stimulohen inovacionet dhe do të rritet oferta e prodhimeve dhe shërbimeve të cilat do të jenë të arritshme për rreth 80 milion njerëz me nevoja të veçanta në BE.

Vëmendje e veçantë është dedikuar në sigurimin e proporcionalitetin e kërkesës, në veçanti për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Me klauzolë të arsyeshme shmangët imponim me përmasa jo të barabartë të kërkesës për qasje, derisa ndërmarrjet e vogla janë paraparë masa më të lehta për harmonizim.

Personat me nevoja të veçanta do të kenë përfitim nga oferta më e madhe të prodhimeve aderuese dhe shërbime për çmime konkurrense. Oferta e përmirësuar do ta shfrytëzojnë edhe persona më të moshuar me nevoja të ngjashme në pikëpamje të aderimit, si dhe të gjithë personat tjerë ballafaqohen me probleme si pasoja të fatkeqësisë, sëmundja e përkohshme dhe mjedise jo të favorshme ose nivel i lartë i zhurmës. Me këtë zgjerohet pjesëmarrja aktive në jetën shoqërore, arsim, punësim dhe krijimin e mundësive më të mëdha për mëvetësi dhe mobilitet.

Rreth 80 milion njerëz në BE ballafaqohen me shkallë të caktuar të invaliditetit. Për shkak të vjetërsisë së popullatës, deri në 2020 pritet numri të arrijë në 120 milion. Aderimi është parakusht për pjesëmarrjen e tyre të barabartë dhe rol aktiv në shoqëri.

Konventa për KB për të drejtat e personave me nevoja të veçanta përmban obligime për qasje. Në atë kërkon anëtare siç është BE dhe vendet anëtare, të ndërmarrin masat e nevojshme, duke përfshirë edhe legjislacionin për sigurim të qasjes.

Nëse BE nuk vepron, çdo vend anëtar do të vazhdojë të përgatitë ligje të ndryshme për plotësimin e obligimeve të tyre, me çka rritet ndarja e tregut të BE. Me marrjen e masave nga ana e BE mund të parandalohet ndarje e tillë e tregut. Mund të ulen shpenzimet për qasje deri te prodhimet dhe shërbimet, që në mënyrë pozitive do të ndikojë mbi buxhetet publike në afatgjatë, me uljen e varshmërisë të personave të moshuar dhe të pa fuqishëm.

Në vitin 2011, BE e ratifikon Konventën për KB për të drejtat e personave me nevoja të veçanta. Në atë invaliditeti shihet si çështje e të drejtave të njeriut, kurse jo nga perspektiva mjekësore ose vullnetare.

Neni 9 i Konventës i përmban obligimet e vendeve anëtare për sigurim të qasjes së barabartë të personave me invaliditet.

Konventa është nënshkruar nga të gjitha vendet anëtare, kurse 25 nga ato e kanë ratifikuar. Finlanda, Irlanda dhe Holanda përgatiten për ratifikim. Kjo do të thotë se BE dhe vendet anëtare të cilat janë nënshkruese të Konventës obligohen në suaza të kompetencave të tyre t'i respektojnë dhe t'i mbrojnë të drejtat e personave me nevoja të veçanta të përcaktuara në Konventën e KB.

http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15

Strategji e re BE për aviacion



Më 7 dhjetor këtë vit Komisioni Evropian miratoi Strategji të re për aviacion, iniciativa e cila do të bazë për forcimin e ekonomisë evropiane, forcimi i bazës industriale dhe pozitës globale lider të BE- që janë tre prioritetet kyçe të kryetarit Zhan-Klod Junker. Nga sektori stabil dhe i hapur jo vetëm që favor do të kenë bizneset, por edhe qytetarët evropian që i ofrohen më shumë lidhje me të tjerët në botë me çmime më të ulëta.

Qëllimi i Komisionit është të krijojë strategji gjithëpërfshirëse për tërë ekosistemin e aviacionit në BE. Në këtë kontekst, prioritetet janë:

1. Të sigurohet rol udhëheqës në BE si faktor udhëheqës në aviacionin ndërkombëtar, duke garantuar rregulla të barabarta të lojës. Përveç rritjes së qasjes së tregut, do të sigurohen edhe mundësi të reja afariste për kompanitë evropiane, kurse me atë edhe ferr konkurrencë dhe kushte tregu transparente në bazë të rregullativës së qartë rregullatore. Me marrëveshjet do të sigurohen më shumë lidhje dhe çmime më të mirë për udhëtarët.

2. Ballafaqimi me kufizimin e rritjes në ajër dhe në tokë. Zgjedhja e problemit me kufizimin e kapacitetit, efikasitetit dhe lidhjen e me sfidën kryesore të aviacionit të BE. Fragmentarizmi i hapësirës ajrore evropiane kushton rreth 5 miliardë euro në vit dhe lirohen deri 50 milion tonë CO2. Për shkak të kapaciteteve kufizuese të aeroporteve në BE mund të vihet deri në humbjen e 818.000 vende pune deri në vitin 2035. Në strategji theksohet rëndësia nga kompletimi plotësues i Projektit të vetëm Evropian - SKY, optimizmi i përdorimit të aeroporteve më profitabil.

3. Mbajtja e standardeve të larta të BE. Në interes të qytetarëve evropian dhe kompanitë me rëndësi esenciale është mbajtja e standardeve të larta në sferat e sigurisë, mbrojtje, mjedis jetësor, çështje sociale dhe të drejtat e qytetarëve. Në Strategjinë janë propozuara masa të rëndësishme në atë drejtim me azhurnimin e rregullave për siguri të BE. Me kornizë rregullatore efektive dhe efikase do të mundësohet fleksibilitet më i madh i industrisë për

progres dhe mirëmbajtje të konkurrencës në nivel global. Komisioni do të kërkojë mënyrë që të ulët barra e kontroleve të sigurisë dhe shpenzimet përmes përdorimit të teknologjisë së re dhe qasje e bazuar në rrezik. Edhe më shumë e forcon dialogun social dhe kushtet për punësim në aviacion do të ndërmerr masa të forta të planit global për arritjen e rritjes neutrale të emisionit të thëngjillit deri në vitin 2020.

Me inovacionet dhe digjitalizimin do të nxitet zhvillimi i aviacionit si tregues të rritjes. Me Strategjinë propozohet kornizë juridike për sigurimin e mbrojtjes dhe sigurisë juridike në rajonin e industrisë me çka do të zgjidhen çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë, siguria dhe mjedisi jetësor. Me investimet adekuate në teknologji dhe inovacion do të sigurohet rol vendimtar i BE në komunikacionin ajror ndërkombëtar.

Bashkimi Evropian planifikon të investojë 430 milion euro në vit deri në vitin 2020 në suaza të projektit për hulumtim të menaxhimit me komunikacion ajror në Qiellin e vetëm Evropian (SESAR). Me zhvillimin e zgjidhjeve të SESAR hapet mundësi për krijimin e 300.000 vende të reja pune.

Aviacioni është tregues kryesor i rritjes ekonomik, vendet e punës, tregtia dhe mobiliteti i BE dhe ka rol kyç në ekonominë e BE. Ky sektor drejtpërdrejt punëson pothuajse 2 milion njerëz në BE dhe realizon 110 miliardë euro nga ekonomia evropiane. Komunikacioni i aviacionit në Evropë parasheh arritje prej 14,4 milion fluturime deri 2035, për 50% më shumë sesa në vitin 2012.

http://europa.eu/rapid/press-release_IP-15-6144_en.htm

TË RINJTË I SHFRYTËZOJNË MEDIAT SOCIALE PËR INFORMACIONE SHËNDETËSORE



Për shumë njerëz të rinj të cilët kanë sëmundje kronike, mediat sociale janë burim i rëndësishëm i informatave shëndetësore, sipas hulumtimit të ri nga Universiteti në Glazgov. Sipas hulumtuesve, praktika e zakonshme në botë është të shfrytëzohen informacione përmes "Google", para se të kryhet konsultim me mjek ose motër medicinale. Të rinjtë prej 18-30 vjet çdo ditë e më shumë kërkojnë dhe i ndjekin këshillat në rrjetet sociale. Sipas hulumtimit, të rinjtë me diabet ose probleme shëndetësore si anksoziteti dhe depresioni, marrin këshilla, përkrahje dhe mirëkuptim për problemet e tyre përmes mediave sociale, ueb faqe Facebook dhe forumet online. Shumica e të rinjëve kërkojnë në internet informata shëndetësore bazike, shprehen si deri më pak depresion dhe shëndet emocional i përmirësuar si dhe përkrahja e të gjithë njerëzve të cilët ballafaqohen me të njëjtën ose probleme shëndetësore të ngjashme.

Studimi i ka analizuar arsyet për të cilat të rinjtë komunikojnë përmes internetit, p.sh. grua e re me diabet ka deklaruar " Internet faqet dedikuar për diabet janë me të vërtetë të mira dhe të favorshme.. mjafton ndonjëherë të dihet se ka edhe njerëz tjerë që janë ballafaquar dhe jetojnë në kushte të njëjta. Djalë i ri i cili lufton me anksozitetin ka deklaruar "Kur ndihesha i deprimuar kërkoja në google si njerëzit tjerë të cilët janë në depresion, vetëm kur kanë kontroll kur ato ballafaqohen me situatën e njëjtë. Nuk dua ta di arsyen, por vetëm të dihet se nuk je i vetmi ti që ndihesh ashtu. Është ndjenjë e mirë kur njerëzit të kuptojnë."

<http://www.euractiv.com/sections/health>

RREGULLA TË REJA TË BE PËR PËRMIRËSIMIN E SAJBER SIGURISË



Më 7 dhjetor 2015, në suaza të Kryesimit të Luksemburgut me Këshillin e BE u arrit marrëveshje me Parlamentin Evropian të rregullave të përbashkëta për forcimin e rrjetit dhe sigurisë informatike të BE.

Me direktivën e re rregullohen obligimet për sajber siguri të operatorit dhe dhënësit të shërbimeve digjitale. Dy kategoritë të dhënësit të shërbimeve do të jenë lëndë e regjimeve të ndryshme.

Direktiva i thekson sektorët kritik në të cilën operatorët në shërbimet themelore janë aktive: Energjetikë, transport, financat dhe shëndetin e njerëzve. Në këto sektorë, shtet do t'i identifikojnë subjektet të cilat i sigurojnë shërbimet bazike në bazë të cilës kriteret janë qartë të përcaktuara në Direktivë. Kërkesat dhe mbikëqyrja do të forcohen për këto operatorë sesa për dhënësit e shërbimeve digjitale, Si shërbime digjitale e cila do të përfshihen me direktivat janë platforma për e- tregti, kërkuesit dhe Cloud shërbime.

Nga çdo vend anëtar të BE kërkohet të emërohet organ kompetent dhe të miratohet strategji për ballafaqim me çështjet nga sfera e sajber sigurisë.

Mes vendeve anëtare të BE do të formohet grup për bashkëpunim dhe këmbimin e

praktikave më të mira. Do të vendoset rrjet të ekipeve nacionale për përgjigje incidentesh të sigurisë së kompjuterëve për promovim të bashkëpunimit operativ.

Vendet anëtare në afat prej 21 muajsh nga hyrja e Direktivës në fuqi duhet t'i miratojnë dispozitat nacionale të nevojshme.

Në periudhë prej 6 muajsh pas kalimit të periudhës për miratimin e dispozitave nacionale vendet duhet t'i identifikojnë operatorët të shërbimeve themelore.

Kryesimi i Luksemburgut më 18.12.2015 e prezantonte marrëveshjes para ambasadave të vendeve anëtare në Komitetin e përfaqësuesve të përhershëm (KOREPER) dhe i njëjti është miratuar.

Që të rrumbullakohet procedura është e nevojshme miratimi formal nga ana e Këshillit dhe të Kuvendit.

<http://www.consilium.europa.eu/en/press/press>

GJUHA IRLANDEZE NË GJUHËN OFICIALE TË BE

Gjuha irlandeze është gjuhë oficiale në BE që nga viti 2007, por tani gradualisht o të kalojë në gjuhë punuese në institucionet evropiane. Shkrimtari irlandez dhe linguist i theksuar Oskar Vajlld, sigurisht do ta kishte përshëndetur këtë barazi gjuhësore.

"Të gjitha kafshët janë të barabarta, por disa kafshë janë më të barabarta nga të tjerët, maksima shpesh e cituar nga ferma e kafshëve e Xhorxh Ovel, duket e favorshme kur bëhet fjalë për raportin e Bashkimit Evropian drejt gjuhës irlandeze.

Edhe krahas asaj që është një nga 24 gjuhët oficiale të Unionit, gjuha irlandeze ekzistonte në hamendje administrative. Kjo do të thotë se institucionet evropiane nuk janë të obliguara të sigurojnë përkthim të tërësishëm ose interpretimin e shërbimeve, siç është rast me 23 gjuhët tjera. Përkthimi është i detyrueshëm vetëm kur bëhet fjalë për bashkë vendime miratuar nga ana e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

Gjuha malteze ishte vënë nën status të

ngjashëm kur Malta u kyç në Union në vitin 2004. Gjuha malteze flitet si gjuhë amë nga rreth gjysmë milion njerëz.

Më 3 dhjetor këtë vit Këshilli paralajmëroi se do të përgatitë rregullativë të re me çka do të rritet numri i sferave që kërkojnë përkthim irlandez, me qëllim tërësisht të vihet fund i fazës së lëshimeve deri në 1 janar 2022.

Sigurisht se shërbimet për përkthim në institucion duhet të zgjerohen me qëllim që të ballafaqohen me vëllim të rritur të punës.

Qytetarët e BE kanë të drejtë të shfrytëzojnë cilin do nga gjuhët zyrtare në shkresat me institucionet e BE, të cilat duhet të përgjigjen në gjuhën e njëjtë.

Çdo institucion i BE ka shërbimet e tyre për përkthim, kurse Drejtoria e Përgjithshme për përkthim e Komisionit ka vëllim më të madh të punës. Drejtoria punon me buxhet prej rreth 330 milion euro në vit. Në vitin 2014 janë përpunuar 2,3 milion faqe. Vlerësimi i shpenzimeve të përgjithshme për përkthim të niveleve të të gjitha institucionet është rreth 1% nga buxheti vjetor i BE, ose 2 euro për kokë banori në BE.



KRYESIMI HOLANDEZ ME KËSHILLIN E BASHKIMIT EVROPIAN



Nga 1 janari deri 30 qershor 2016 Mbretëria Holandeze do të kryesojë me Këshillin e Bashkimit Evropian.

Me Kryesimin Holandez fillon periudha e "treshes" së re në kryet e BE: Holanda, Sllovenia dhe Malta. Kryesimet paraprake të Holandës u shënuan me Traktati i Matrihtit (1992) dhe Traktati i Amsterdamit (1997). Kryesimin holandez e presin sfida të mëdha.

Në fokusin e agjendës së kryesimit pritet të jenë temat kyçe: Forcimi i rolit të BE si aktor global, sfidat me krizën e emigrantëve për energjetikë dhe ndryshime klimatike, forcimi i financave publike të Eurozonës.

<http://english.eu2016.nl/>

**BE KALENDAR / JANAR 2016**

Kryesimi holandez me Këshillin e BE-01.01.2016-31.06.2016

2. Seanca plenare e Parlamentit Evropian 18-21/01/2016, Strazbur;

European Union Newsroom

Home Highlights Press releases Calendar Audiovisual Press contacts Press facilities About the EU

CALENDAR

BROWSE FORTHCOMING EVENTS

By topic: Choose a topic

By organiser: Choose an organiser

By type: Choose a type

BY MONTH

January 2016

Mo	Tu	We	Th	Fr	Sa	Su
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31



KUVENDIN I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

UE QENDRA E KUVENDIT

Адреса: 11 Октомври бр. 10, Скопје, 1000

Telefon: +389 2 3 11 22 33 lokal 414 dhe 289

Faks: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

Zyra për përkrahje të Këshillit kombëtar për
euorintegritime

www.sobranie.mk

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në periudhën janar 2011-qershor 2012 ishte zbatuar IPA Projekti për "Ndihmë teknike për Parlamentin", qëllimi i përgjithshëm i të cilës ishte përforsimi i kapacitetit institucional të Kuvendit dhe me atë përmirësim të transparencës dhe përgjegjësisë të saj para qytetarëve.

Në korniza të IPA projektit, ishte siguruar ndihmë financiare dhe profesionale për vendosje të UE qendre në Kuvend.

Qëllimi i formimit të UE qendrës është deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe Shërbimit të Kuvendit t'u sigurohet qasje më e mirë në informata të lidhura me UE çështjet.